

DEPARTAMENTI I STATISTIKËS DHE INFORMATIKËS SË ZBATUAR

I. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për t'u përfshirë në programin e doktoratës në shkencë ekonomike në Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së zbatuar:

- a. Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkencë Ekonomike, profili “Informatika Ekonomike”, duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe/ose Master Shkencor në Shkencë Ekonomike, Informatikë Ekonomike ose të përafërta me to.
- b. Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit së bashku, (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND), me notë mesatare të ponderuar 8 e lart.
- c. Në rastet kur aplikanti ka mbi 10 vite akademike të angazhuar si lektor me kohë të plotë në procesin e mësimdhënies, kandidati përjashtohet nga kriteri i mesatares.
- d. Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përkatëse për Arsimin.
- e. Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të shkencave ekonomike, Informatikës Ekonomike ose në fusha të përafërta.
- f. Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, pika 1 dhe 3). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- g. Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor, të dakortësuar me Udhëheqësin Shkencor.
- h. Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkencë Ekonomike, profili “Informatika Ekonomike”, të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
- i. Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës të paktën nga 2 profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
- j. Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e Shkencave Ekonomike, Informatika Ekonomike ose të përafërta me to.
- k. Kandidati duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 2 vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një institucion të Arsimin të Lartë, apo institucione të kërkimit bazë apo të zbatuar. Përjashtohen nga ky kriter studentët e ekselencës.

II. Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar.

a. Diploma e fituar, kriteri (a)	<u>(maksimumi 400 pikë)</u>	
i. Bachelor në Shkenca Ekonomike ose Informatikë e Zbatuar		200 pikë
ii. Master Shkencor në Shkenca Ekonomike ose Informatikë Ekonomike		200 pikë
iii. Bachelor, programe të përafërta		150 pikë
iv. Master Shkencor, programe të përafërta		150 pikë
b. Nota mesatare, kriteri (b)	<u>(maksimumi 250 pikë)</u>	
i. 9.51 – 10.00		250 pikë
ii. 9.01 – 9.50		210 pikë
iii. 8.51 – 9.00		180 pikë
iv. 8.00 – 8.50		150 pikë
c. Njohuri në gjuhë të huaja, kriteri (e)	<u>(maksimumi 200 pikë)</u>	
i. Më shumë sesa një gjuhë e huaj		200 pikë
ii. Një gjuhë e huaj		150 pikë
d. Pjesmarje në konferenca dhe revista shkencore, kriteri (j)	<u>(maksimumi 150 pikë)</u>	
i. Më shumë sesa 2		150 pikë
ii. Deri në 2		100 pikë